

URDHËR
Nr. 119/1, datë 7.6.2022

PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT TË PRAKTIKËS KLINIKE
PËR SHËRBIMIN E ORTHOPTIKËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 19.1.2022, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2022”, si edhe në urdhrin nr. 119, datë 17.2.2022, “Mbi hartimin e Udhërrëfyesit të Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës”, me qëllim zbatimin në praktikë të Udhërrëfyesit të Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Udhërrëfyesit të Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës (në format elektronik CD), sipas listës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri, përgatitur nga grupi i punës i ngarkuar për këtë qëllim.

2. Ngarkohet gjithë personeli mjekësor në institucionet e kujdesit shëndetësor publik, që në praktikën e përditshme mjekësore të udhëhiqen nga Udhërrëfyesi i Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës.

3. Ngarkohen drejtorët e spitaleve dhe përgjegjësit e shërbimeve për njohjen dhe pajisjen e shërbimeve me Udhërrëfyesin e Praktikës Klinike të Shërbimit të Orthoptikës, si edhe ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Mira Rakacolli